

VENDIM
Nr. 25, datë 30.3.2018

**PËR MOSMARRJEN NË SHQYRTIM TË APLIKIMIT PËR MIRATIMIN E TARIFAVE
TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA PËR
SHOQËRINË UJËSJELLËS-KANALIZIME SHKODËR**

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë dhe të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”; të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 39, datë 9.12.2015, “Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”; të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 9.12.2015, “Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura”; të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 9.12.2015, “Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura” dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 9.12.2015, “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura”, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike mbi aplikimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Shkodër sh.a., për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura, Komisioni Kombëtar Rregullator

konstatoi se:

- Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Shkodër është licencuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator, me vendimin nr. 55, datë 29.12.2017, “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Shkodër”.

- Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Shkodër, me anë të shkresës nr. 739 prot., datë 30.6.2017, ka aplikuar për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura.

- Dosja e aplikimit u paraqit me mungesa në dokumentacion, si” “Vendimi i Këshillit Bashkiak si opinion për tarifat e reja të propozuara”, “Raporti i ekspertit kontabël”, “Procesverbali i seancës dëgjimore me publikun” dhe “Modeli i aplikimit” dhe u plotësua pjesërisht vetëm pas insistimit të Entit Rregullator të Ujit.

- Edhe pas kërkesave të Entit Rregullator të Ujit, “Vendimi i Këshillit Bashkiak si opinion për tarifat e reja të propozuara”, ende nuk është paraqitur.

- Në mbledhjen e datës 30.3.2018, Komisioni Kombëtar Rregullator analizoi dhe një herë situatën e aplikimeve për ndryshimin e tarifave dhe gjykoi se ka kaluar një periudhë e gjatë bashkëpunimi ku shoqëria UK Shkodër ende nuk është treguar korrekte me plotësimin e dokumentacionit të kërkuar me qëllim vijimin e procedurës nga ERRU-ja.

Për sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Të mos marrë në shqyrtim aplikimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Shkodër sh.a. për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura.

2. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Shkodër detyrohet të aplikojë për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura me dokumentacionin dhe të dhënat e plota, brenda datës 30.6.2018, pasi në të kundërt do të zbatohen saksionet që parashikon ligji në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ndriçim Shani